

LISTA E INSTITUCIONEVE NE VARESI TE MINISTRISE SE SHENDETESISE

- 1. Autoriteti Shendetesor Rajonal Tirane**
- 2. Instituti i Shendetit Publik**
- 3. Qendra Kombetare e Transfuzionit te Gjakut**
- 4. Qendra Kombetare e Mirerritjes Zhvillimit dhe Rehabilitimit te Femijeve**
- 5. Klinika Stomatologjike Universitare**
- 6. Njesia E Transportit Mjekesor me Helikopter**
- 7. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore**
- 8. Oficina Elektro Mjekesore**
- 9. Qendra Kombetare e Cilesise Sigurise dhe Akreditimit te Institucioneve Shendetesore**
- 10. Klinika e Sherbimeve Shendetesore (Qeveritare)**
- 11. Qendra Kombetare Edukimit ne Vazhdim**
- 12. Drejtorite e Shendetit Publik (11 rajonale dhe 24 rrethi) 35 gjithsej**
- 13. Spitalet psikiatrike (Vlore, Shkoder, Elbasan)**

MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Krijimi

Ministria e Shëndetësisë është krijuar për herë të parë në vitin 1944.

Funksionimi

Në bazë të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe ligjit Nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 10, viti 2003, faqja 281 .

Misioni

Ministria e Shëndetësisë ka si mision të saj ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të veta në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e tjera të Republikës së Shqipërisë për hartimin dhe zbatimin e politikave shtetërore që sigurojnë realizimin e politikës shëndetësore në përputhje me programin e qeverisë. Si pjesë përbërëse e strukturës së pushtetit qendror, Ministria e Shëndetësisë, mbështet Ministrin e Shëndetësisë në zhvillimin e përgjegjësisive të tij përpara Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave për çështjet e Shëndetësisë.

Veprimtaria Kryesore

- harton politikën shëndetësore në shkallë vendi, përcakton zhvillimin, planifikimin e shërbimit shëndetësor në nivel kombëtar dhe lokal.
- harton dhe zbaton legjislacionin që rregullon marrëdhëniet në fushën e mbrojtjes së shëndetit duke synuar kërkesat e standarteve europiane.
- harton strategjinë e zhvillimit shëndetësor dhe programin e punës për realizimin e programit të Qeverisë.
- pasqyron, në programin e zhvillimit të sistemit shëndetësor politikat dhe udhëzimet e Këshillit të Ministrave për fushën e shëndetësisë.
- siguron mbarëvajtjen e sektorit dhe menaxhimin optimal të burimeve njerëzore, financiare e materiale të disponueshme.
- kryen negociimet për zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e shëndetësisë, bën përgatitjet e domosdoshme për zgjerimin e aderimit të vendit në organizmat ndërkombëtare dhe ndjek zbatimin e tyre.
- organizon kontrollin dhe funksionin e bashkërendimit për institucionet dhe njësitë në varësi të MSH.
- studion, harton dhe ndjek zbatimin e programit të investimeve publike për zhvillimin e infrastrukturës së shërbimit publik shëndetësor.

Shërbimet

Ministria e Shëndetësisë kryen drejtimin operativ të sektorit shëndetësor në shkallë kombëtare dhe sipas ndarjes administrative.

Statusi institucional

Është institucion në varësi të Këshillit të Ministrave

Financimi

Financimi bëhet nga buxheti i shtetit

Organizimi

Struktura dhe organika përcaktohen me urdhër Kryeministri.

Numri i punonjësve

Numri i punonjësve është 100

Emrimi, shkarkimi lirimi i punonjësve

Në bazë të Ligjit Nr. 8549 datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", ligjit nr.7961, datë 2.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.16, viti 1995, faqja 660, kontratës kolektive dhe rregullores.

Pagat

Pagat përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Marrëdhëniet me Institucionet e tjera

Këshilli i Ministrave, Ministrinë e linjave, institucionet vartëse, Avokati i Popullit, urdhërat profesionalë, organizatat joqeveritare, etj...

AUTORITETI SHËNDETËSOR RAJONAL TIRANË

Krijimi

Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 394, datë 27.07.2000, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shëndetësor Rajonal të Tiranës", botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 27, viti 2000, faqja 1380 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 654, datë 21.11.2001 "Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shëndetësor Rajonal të Tiranës", miratuar me vendimin nr.394, datë 27.7.2000 të Këshillit të Ministrave, botuar në Fletoren Zyrtare Nr 55, viti 2001, faqja 1751.

Funksionimi

Funksionon në bazë të rregullores së miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 654, datë 21.11.2001 "Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shëndetësor Rajonal të Tiranës" bashkëngjitur Vendimit Nr. 394, date 27.07.2000, botuar në Fletoren Zyrtare Nr 55, viti 2001, faqja 1751.

Misioni

Ofrimi i Shërbimit Shëndetësor parësor, mjekut të familjes, shërbimit të specializuar ambulator nëpërmjet kontraktimit të këtyre shërbimeve shërbimeve nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

Veprimtaria Kryesore

Ofrimi i kujdesit shëndetësor parësor si dhe atij të specializuar ambulator.

Shërbimet

Siguron shërbimin parësor dhe të specializuar ambulator.

Statusi institucional

Eshtë në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë.

Financimi

Shërbimet në poliklinika dhe Qendra shëndetësore financohen nga skema e sigurimeve shëndetësore. Administrata, qendrat e Komunitare të Shëndetit Mendor dhe Drejtoria e Shëndetit Publik financohen nga Ministria e Shëndetësisë.

Organizimi

Struktura dhe organika përcaktohen nga Ministri i Shëndetësisë.

Numri i punonjësve

Numri i punonjësve është 505.

Emërimi, shkarkimi lirimi i punonjësve

Emërimi i Drejtorit Ekzekutiv bëhet sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 394, datë 27.07.2000, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shëndetësor Rajonal të Tiranës" dhe VKM Nr. 654, datë 21.11.2001 "Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shëndetësor Rajonal të Tiranës", miratuar me vendimin nr. 394, datë 27.7.2000 të Këshillit të Ministrave, botuar në Fletoren Zyrtare Nr 55, viti 2001, faqja 1751 dhe e personeli tjetër bëhet në bazë ligjit Nr.7961, datë 2.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.16, viti 1995, faqja 660, kontratës kolektive dhe rregullores, nëpërmjet bordit.

Pagat

Pagat përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Marredheniet me Institucionet e tjera

Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Kujdesit Shëndetësor, Prefektura, Bashki, shkolla publike.

INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK "HULO HADËRI" TIRANË

Krijimi

Është krijuar në vitin 1969 dhe është riorganizuar me Vendimin e Këshillit Ministrave Nr. 178, datë 30.03.2001, "Për bashkimin e Qendrës Kombëtare të edukimit dhe Promocionit të shëndetit me Institutin e Shëndetit Publik" botuar në Fletoren Zyrtare Nr 19, viti 2001 faqja 593.

Funksionimi

Funksionon në bazë të rregullores së dhe të udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë.

Misioni

Studimin dhe monitorimin e faktorëve të riskut,urvejancën e sëmundjeve ngjitëse, referencën laboratorike si edhe menaxhimin e programeve të vaksinimit. Zbatimi i mjaft programeve afatshkurtra me natyrë studimore apo promovuese të shëndetit është gjithashtu pjesë e aktivitetit të tij. Instituti i Shëndetit Publik luan edhe një rol të rëndësishëm lidhur me trainimin në fushën e shëndetit publik.

Veprimtaritë kryesore

Monitorimin e gjendjes shëndetësore për të identifikuar dhe zgjidhur në kohë problemet shëndetësore të popullatës.
Identifikimin dhe analizimin e shkaqeve të problemeve shëndetësore si dhe i risqeve për shëndetin në popullatë;
Informimin, edukimin dhe ndërgjegjësimin e njerëzve mbi problemet shëndetësore;
Sigurimin e edukimit të vazhdueshëm dhe mbështetjes profesionale për specialistet e shëndetit publik. Kërkimin shkencor për të ofruar zgjidhje inovative të problemeve shëndetësore dhe për ndërtimin e strategjive efektive të parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve.

Statusi institucional

Është institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë.

Financimi

Financimi bëhet nga buxheti i shtetit.

Shërbimet

Rregullator, Ofrues Shërbimesh dhe Shërbime mbështetëse.

Organizimi

Struktura dhe organika përcaktohen nga Ministria e Shëndetësisë.

Numri i punonjësve

Numri i punonjësve : 206

Emërimi, shkarkimi lirimi i punonjësve

Në bazë të ligjit Nr.7961, datë 2.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar botuar në Fletoren Zyrtare Nr.16, viti 1995 faqja 660, kontratës kolektive dhe rregullores.

Pagat

Përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Marrëdhëniet me Institucionet e tjera

Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mjedisit, Ministria e Bujqësisë, Fakulteti i Mjekësisë, Prefektura, Bashkia, Drejtoria e Ujësjiellës Kanalizimeve.

QENDRA KOMBËTARE E TRANSFUZIONIT TË GJAKUT

Krijimi

Ky institucion është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit Nr.8032, datë 16.11.1995 i ndryshuar me ligjin Nr 9415 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 8032, datë 16.11.1995 "Për shërbimin e transfuzionit dhe kontrollin e gjakut dhe produkteve të tij", i ndryshuar botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 45 viti 2005 faqja 1634.

Funksionimi

Funksionon në bazë të rregullores si dhe të udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë të dalë nga ky ligj të cilat janë të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe janë të përmbledhura në Udhëzuesin për Sigurinë e Gjakut dhe Produkteve të tij.

Misioni

Sigurimin e gjakut dhe produkteve të tij për të plotësuar në mënyrën me optimale kërkesat që nevojiten për tranfuzione.

Veprimtaria kryesore

Sigurimi i nevojave për gjak në spitale dhe shërbime spitalore.

Shërbimet

Mbledhja, seleksionimi, përpunimi, testimi shpërndarja e gjakut dhe e produkteve të tij.

Statusi institucional

Është institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë.

Financimi

Financimi bëhet nga buxheti i shtetit.

Organizimi

Struktura dhe organika përcaktohen nga Ministria e Shëndetësisë.

Numri i punonjësve

Numri i punonjësve 57

Emërimi, shkarkimi lirimi i punonjësve

Në bazë ligjit Nr.7961, datë 2.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.16, viti 1995, faqja 660, kontratës kolektive dhe rregullores.

Pagat

Përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Marredheniet me Institucionet e tjera

Ministria e Shëndetësisë, Spitalet Universitare, Spitalet Rajonale, Shërbimet Spitalore, etj...

QENDRA KOMBËTARE E MIRËRRITJES ZHVILLIMIT DHE REHABILITIMIT TË FËMIJËVE TIRANË

Krijimi

Kjo qendër është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 325, Date 23.06.2000 "Për krijimin e qendrës kombëtare për mirërritjen zhvillimin dhe rehabilitimin e fëmijëve si njësi e veçantë" botuar në Fletoren Zyrtare Nr.18, viti 2000, faqja 889.

Funksionimi

Funksionon në bazë të rregullores.

Misioni

Përmirësimi i cilësisë së jetës së fëmijëve me nevoja të veçanta, si dhe mbështetja e familjeve të tyre në procesin e mirërritjes, kujdesit dhe edukimit të fëmijëve.

Veprimtaria kryesore

Mirërritja dhe rehabilitimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara fizike dhe psiqike.

Statusi institucional

Është institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë.

Financimi

Financimi bëhet nga buxheti i shtetit.

Organizimi

Struktura dhe organika përcaktohen nga Ministria e Shëndetësisë.

Numri i punonjësve

Numri i punonjësve

62

Emërimi, shkarkimi lirimi i punonjësve

Në bazë ligjit Nr.7961, datë 2.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.16, viti 1995 faqja 660, kontratës kolektive dhe rregullores.

Pagat

Përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Marredheniet me Institucionet e tjera

Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës dhe Shanseve të Barabarta, etj...

KLINIKA STOMATOLOGJIKE UNIVERSITARE

Krijimi

Kjo klinikë është krijuar në vitin 1993.

Misioni

Përgatitja e studentëve dhe mjekëve stomatologe specializante në specialitetet: Kirurgji, Terapi, Ortopedi, Pedodonti.

Funksionimi

Funksionon në bazë të rregullores si dhe të udhezimeve përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë.

Veprimtaria kryesore

Ofron shërbime të specializuara në: Kirurgji maximo-faciale, Terapi, Ortopedi, Pedodonti.

Shërbimet

Siguron formimin profesional të mjekëve specializante .

Statusi institucional

Është institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë.

Financimi

Financimi bëhet nga buxheti i shtetit.

Organizimi

Struktura dhe organika përcaktohen nga Ministria e Shëndetësisë.

Numri i punonjësve

Numri i punonjësve : 43

Emërimi, shkarkimi lirimi i punonjësve

Në bazë ligjit nr.7961, datë 2.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.16, viti 1995 faqja 660, kontratës kolektive dhe rregullores.

Pagat

Përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Marrëdhëniet me Institucionet e tjera

Ministria e Shëndetësisë, Fakulteti Mjekësor.

NJËSIA E TRANSPORTIT MJEKËSOR ME HELIKOPTER

Krijimi

Kjo njësi është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 135 datë 20.3.1995 "Për krijimin dhe funksionimin e njesise se transportit mjekësor me helikopter" dhe është riorganizuar me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë Nr. 8 datë 08/01/2001 " Për ndarjen e Njesisë të Transportit Mjekësor me helikopter nga struktura e Drejtorisë të Autoritetit Shëndetësor Rajonal Tiranë"

Funksionimi

Funksionon në bazë rregullores.

Misioni

Mbulimi i urgjencave mjekësore kur paraqitet nevoja për ofrimin e një shërbimi të tillë.

Veprimtaria kryesore

Transportimin e specializuar mjekësor me helikopter të pacientëve në raste akute .

Statusi institucional

Është institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë.

Financimi

Financimi bëhet nga buxheti i shtetit.

Organizimi

Struktura dhe organika përcaktohen nga Ministria e Shëndetësisë.

Numri i punonjësve

Numri i punonjësve : 14

Emrimi, shkarkimi lirimi i punonjesve

Në bazë ligjit Nr.7961, datë 2.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.16, viti 1995 faqja 660, kontratës kolektive dhe rregullores.

Pagat

Pagat përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Marrëdhëniet me Institucionet e tjera

Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Brendshme, (Emergjencat Civile), Ministria e Mbrojtjes, Spitalet në rrethe.

QËNDRA KOMBËTARE E KONTROLLIT TE BARNAVE

Krijimi

Kjo qendër është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 60 datë 11/02/1993 "Për Krijimin e Qendrës Kombëtare të Kontrollit të Barnave" botuar në Fletoren Zyrtare Nr.2, viti 1993, faqja 142.

Funksionimi

Kjo qendër funksionon në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 60 datë 11/02/1993 "Për Krijimin e Qendrës Kombëtare të Kontrollit të Barnave", në bazë të rregullores si dhe të udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ligjit Nr. 9323 date 25.11.2004 "Per barnat dhe shërbimin farmaceutik" botuar në fletoren zyrtare N. 107 vitit 2004 faqja 7105.

Misioni

Institucion I specializuar për regjistrimin, analizën e barnave si dhe inspektimin dhe kontrollin e çdo lloj veprimtarie në fushën farmaceutike.

Veprimtaria kryesore

- 1 Kontrollon dhe inspekton të gjitha subjekteve farmaceutike private dhe shtetërore.
 - a. Farmaci
 - b. Agjenci farmaceutike
 - c. Depo farmaceutike
 - d. Fabrika farmaceutike
2. Kryen regjistrimin e barnave (prodhim vendi dhe importi) dhe analizat e tyre.

Shërbimet

Sigurimi dhe përdorimi racional i barnave të sigurta me cilësi të lartë.

Statusi institucional

Është institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë.

Financimi

Financimi bëhet nga buxheti i shtetit.

Organizimi

Struktura dhe organika përcaktohen nga Ministria e Shëndetësisë.

Numri i punonjësve

Numri i punonjësve : 64

Emërimi, shkarkimi lirimi i punonjësve

Në bazë ligjit Nr.7961, datë 2.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.16, viti 1995 faqja 660, kontratës kolektive dhe rregullores.

Pagat

Pagat përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Marrëdhëniet me Institucionet e tjera

Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave, Instituti i Kujdesit Shëndetësor, Qendra Kombëtare e Licensimit , etj...

QENDRA BIOMJEKËSORE

Funksionimi

Në bazë të kodit të punës dhe rregullores.

Misioni

Profilaksia dhe mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore, Menaxhimin e Sistemit të Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (SIPM). Menaxhimin e bazës së të dhënave të personave që hedhin në treg pajisje mjekësore dhe të bazës së të dhënave të ngjarjeve të padëshiruara. Mundësi përdorimi të informacionit dhe komunikim me c. bazën e të dhënave europiane për pajisjet.

Veprimtaria kryesore

Në fushën e planifikimit strategjik të pajisjeve mjekësore si prokurimi si dhe për çështje të tilla si: kontrollet e sigurisë, kontratat e shërbimeve, mirëmbajtja, përdorimi i sigurt dhe nxjerrja jashtë përdorimit dhe eliminimi i pajisjeve mjekësore.

Shërbimet

T'u ofrojë pacientëve, përdoruesve dhe palëve të treta siguri dhe nivel të lartë mbrojtjeje të shëndetit si dhe të arrijë dhe të ruajë nivele të performancës së pajisjeve mjekësore siç janë përcaktuar nga prodhuesit e tyre. Të ndihmojë përdoruesit për të përfituar të gjitha përparësitë që pajisjet mjekësore moderne .

Statusi institucional

Është institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë.

Financimi

Financimi bëhet nga buxheti i shtetit.

Organizimi

Struktura dhe organika përcaktohen nga Ministria e Shëndetësisë.

Numri i punonjësve

Numri i punonjësve: 16

Emërimi, shkarkimi lirimi i punonjësve

Në bazë ligjit Nr.7961, datë 2.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.16, viti 1995 faqja 660, kontratës kolektive dhe rregullores.

Pagat

Pagat përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Marrëdhëniet me Institucionet e tjera

Ministria e Shëndetësisë, institucionet e varësisë, shërbimet spitalore

QËNDRA KOMBËTARE E CILËSISË SIGURISË DHE AKREDITIMIT TË INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE

Krijimi

Kjo qendër është krijuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 230 datë 15/04/2005 "Për krijimin dhe funksionimin e qendrës kombëtare të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit të institucioneve shëndetësore dhe për një shtesë në vendimin nr.306, datë 27.6.2002 të këshillit të ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e ministrisë së shëndetësisë", të ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 25 viti 2005 faqja 978.

Funksionimi

Funksionon në bazë të rregullores si dhe të udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë.

Misioni

Të mbështetë Ministrinë e Shëndetësisë në zbatimin e strategjise së saj afatgjatë lidhur me përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë të kujdesit shëndetësor, konform eksperiencës dhe praktikës shkencore me pozitive dhe standarteve ndërkombëtare.

Veprimtaria kryesore

Përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së sistemit shëndetësor, nëpërmjet metodave të matjes dhe zbatimit të standardeve të treguesve të matshëm për sistemin shëndetësor.
Edukimin dhe trajnimin e personelit mjekësor dhe partnerëve të tjerë, në lidhje me cilësinë e kujdesit mjekësor dhe krijimit të një kulture të re për të.
Rilicensimi periodik i personelit mjekësor, në sektorët publik dhe privat.
Formulimin, përhapjen dhe monitorimin e udhëzuesve klinik (protokolleve klinike) të praktikës klinike më të mirë, në ndihmë të personelit mjekësor.
Akreditimin e institucioneve shëndetësore shqiptare publike dhe private.
Edukimin terapeutik dhe fuqizimin e rolit të pacientëve si aktorë kryesor e qendror të sistemit shëndetësor.
Minimizimin e rreziqeve dhe gabimeve në institucionet mjekësore: Rritjen e sigurisë për pacientet dhe personelin mjekësor.
Vlerësimin dhe përzgjedhjen e teknologjive ekzistuese dhe të reja më të nevojshme dhe më kostefektive të sistemit shëndetësor.

Statusi institucional

Është institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë.

Financimi

Financimi bëhet nga buxheti i shtetit.

Organizimi

Struktura dhe organika përcaktohen nga Ministria e Shëndetësisë.

Numri i punonjësve

Numri i punonjësve

11

Emërimi, shkarkimi lirimi i punonjësve

Në bazë ligjit nr.7961, datë 2.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.16, viti 1995 faqja 660, kontratës kolektive dhe rregullores.

Pagat

Pagat përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Marrëdhëniet me Institucionet e tjera

Ministria e Shëndetësisë, institucionet në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë

KLINIKA E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE (QEVERITARE)

Krijimi

Kjo klinikë është riorganizuar në vitin 1992.

Funksionimi

Në bazë të rregullores.

Misioni

Ofrimi i shërbimit të urgjencës dhe kujdesit parësor për autotitet e larta të shtetit.

Shërbimet

Shoqëron delegacionet qeveritare për të mundësuar dhënien e ndihmës së shpejtë shëndetësore në rast nevojë.

Statusi institucional

Është institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë.

Financimi

Financimi bëhet nga buxheti i shtetit.

Organizimi

Struktura dhe organika përcaktohen nga Ministria e Shëndetësisë.

Numri i punonjësve

Numri i punonjësve

21

Emërimi, shkarkimi lirimi i punonjësve

Në bazë ligjit nr.7961, datë 2.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.16, viti 1995 faqja 660, kontratës kolektive dhe rregullores.

Pagat

Pagat përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Marrëdhëniet me Institucionet e tjera

Ministria e Shëndetësisë, shërbimet qeveritare, Gardën e Republikës.

QENDRA KOMBETARE E EDUKIMIT NE VAZHDIM

Krijimi

Është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 825 date 14.05.2008 "Për krijimin dhe funksionimin e qendrës kombëtare të edukimit në vazhdim të punonjësve të shëndetësisë dhe për një shtesë në Vendimin nr. 306 datë 27.06.2002 të Këshillit të Ministrave" botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 108 viti 2008 faqja 4780 .

Funksionimi

Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 825 datë 14.05.2008 "Për krijimin dhe funksionimin e qendrës kombëtare të edukimit në vazhdim të punonjësve të shëndetësisë.

Misioni

Nxitja realizimi dhe përmirësimi i zhvillimit profesional të gjithë kategorive të personelit profesional me synim rritjen e njohurive dhe zhvillimin e aftësive të këtij personeli.

Veprimtaria kryesore

Hartim i planit kombëtar të veprimeve të formimit të vazhdueshëm të punonjësve të shëndetësisë.

Shërbimet

Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim shërben si agjenci teknike e Ministrisë së Shëndetësisë për:

- a) planifikimin, bashkëpunimin dhe zbatimin e programeve të formimit të vazhdueshëm të punonjësve të shëndetësisë;
- b) bashkërendimin e punës dhe realizimin e procesit të akreditimit të programeve dhe veprimtarive të zhvillimit profesional, pa përfshirë programet, që varen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës e strukturat e saj.
- c) procesin e certifikimit të personelit të shëndetësisë.
- d) realizimin e studimeve të vlerësimit të nevojave për formim të vazhdueshëm, për kategori të ndryshme të punonjësve të shëndetësisë ose për sektorin e shëndetësisë, në përgjithësi.
- e) vënien në zbatim të programeve të trajnimit, përmes mobilizimit dhe kontraktimit të universiteteve, shkollave universitare, institucioneve akademike, si dhe organizatave të specializuara, shqiptare ose të huaja.

Statusi institucional

Është institucion ne varësi të Ministrisë së Shëndetësisë.

Financimi

Financimi bëhet nga buxheti i shtetit.

Organizimi

Struktura dhe organika përcaktohen nga Ministria e Shëndetësisë.

Numri i punonjësve

Numri i punonjësve është 21

Emërimi, shkarkimi lirimi i punonjësve

Në bazë ligjit nr.7961, datë 2.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.16, viti 1995 faqja 660, kontratës kolektive dhe rregullore.

Pagat

Përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Marrëdhëniet me Institucionet e tjera

Ministria e Shëndetësisë, Fakulteti i Mjekësisë, institucionet shëndetësore, me urdhrin e mjekut, me urdhrin e farmacistëve, urdhrin infermiereve.

DREJTORITË E SHËNDETIT PUBLIK

Krijimi

Drejtoritë e Shëndetit Publik nëpër rrethe janë krijuar në zbatimin të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 376 datë 12.06.1992.

Funksionimi

Në bazë të rregullore "Për funksionimin e Drejtorive të Shëndetit Publik".

Misioni

Zbaton politikat shëndetësore të Ministrisë së Shëndetësisë nëpërmjet strukturave të përfshira në të që miratohen nga Ministria e Shëndetësisë.

Veprimtaria kryesore

Organizimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor monitorimi i cilësisë së tyre, grumbullimi i informacionit shëndetësor dhe vlerësimi i nevojave për trajnimin profesional.

Shërbimet

Kujdesi shëndetësor parësor, shëndeti publik.

Financimi

Financimi dhe buxheti i shtetit.

Organizimi

Struktura dhe organika përcaktohen nga Ministria e Shëndetësisë.

Numri i Punonjësve

Numri i Punonjesve: Totali:

Emërimi, shkarkimi lirimi i punonjësve

Në bazë ligjit nr.7961, datë 2.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.16, viti 1995 faqja 660, kontratës kolektive dhe rregullores.

Pagat

Përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Marrëdhëniet me institucionet e tjera

Prefekturë, Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, bashki, komuna.

SPITALET PSIKIATRIKE

Krijimi

Funksionimi

Funksionon në bazë të Ligjit Nr. 8092 datë 21.3.1996 dhe rregullores së shërbimeve të shëndetit mendor.

Misioni

Sigurimin e vlerësimit psikiatrik, diagnostikimit dhe hartimit të planit individual të trajtimit medikamentar dhe terapisë psikiatrike dhe rehabilituese.

Veprimtaria kryesore

Ofron kushte të përshtatshme për trajtimin mjekësor të shtetasve me çrregullime psiqike akute dhe kronike.

Sherbimet

Ofron shërbimin psikiatrik për të sëmuret akut dhe kronik në repartet e psikiatrisë.

Financimi

Financimi bëhet nga Buxheti i shtetit.

Organizimi

Struktura dhe organika përcaktohen nga Ministri i Shëndetësisë, në bazë të Ligjit Nr. 9106 datë 17.7.2003 "Për shërbimin spitalor" Kreu III ,neni 23, pika 2.

Numri i Punonjesve

Spitali Psikiatrik Vlorë 151, spitali Psikiatrik Elbasan 193, shërbimi spitalor Psikiatrik Shkoder 105.

Emërimi, shkarkimi lirimi i punonjësve

Në bazë ligjit nr.7961, datë 2.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.16, viti 1995 faqja 660, kontratës kolektive dhe rregullores.

Pagat

Pagat pëcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave

Marrëdhëniet me institucionet e tjera

Ministria e Shendetësisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes së Mjedisit, Ministria e Punës e Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Gjykatat, Avokati I Popullit, Organizatat e ndryshme joqeveritare etj...